



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1676/4 prot.

Datë 13.09.2021

**V E N D I M**  
**Nr. 607/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.09.2021, shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me nr.1676 prot., datë 08.09.2021 të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” dshh & “Desaret Company” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-99257-06-25-2021, me objekt “Ndërtim rruga "Havzi Nela"Paskuqan 1", me fond limit 12,972,706.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” dshh & “Desaret Company” SHPK  
*Rruga “Xhorxhi Martini” nr.20, godinë 11 katëshe, shk 2, kt7 Tiranë*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kamëz  
*Bulevardi Blu” nr.492 Kamëz, Tiranë*
- Baza Ligjore:** Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020  
“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e  
Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik  
gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### ***Vlerësimi paraprak***

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

### **II**

#### ***Rrethanat e çështjes***

II.1. Në datën 28.06.2021, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur,” me Nr. REF-99257-06-25-2021, me objekt “Ndërtim rruga "Havzi Nela"Paskuqan 1", me fond limit 12,972,706.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 08.09.2021, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje&Hidro Company” dshh & “Desaret Company” SHPK duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tyre nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 10.09.2021, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje&Hidro Company” dshh & “Desaret Company” SHPK, me anë të shkresës nr.39 prot., datë 09.09.2021 protokolluar me tonën me nr. 1676/3 prot., datë 10.09.2021, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-99257-06-

25-2021, me objekt "Ndërtim rruga "Havzi Nela"Paskuqan 1", me fond limit 12,972,706.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

### III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e bashkimit të operatorëve ekonomi ankimues "Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje&Hidro Company" dshh & "Desaret Company" SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit: "Procedurë e hapur" me Nr. REF-99257-06-25-2021, me objekt "Ndërtim rruga "Havzi Nela"Paskuqan 1", me fond limit 12,972,706.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" parashikohet:

*"1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.*

*2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes."*

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr.1676 prot., datë 08.09.2021 për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 "Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik", nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-99257-06-25-2021, me objekt “Ndërtim rruga "Havzi Nela"Paskuqan 1", me fond limit 12,972,706.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje&Hidro Company” dshh & “Desaret Company” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**